

151-524-BR



FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

DATE: 01/03/2021

I. TË DHËNAT PERSONALE

A. Gjenealitetet aktuale

EMËR	ILIR
MBIEMËR	OBONI
ATËSI	FAIK
AMËSI	ESMA
DATËLINDJE	01.05.1964
VENDLINDJE	TAPI, KUÇOVË
VENDBANIM	TAPI, KUÇOVË
NR. ID	G40501335P

B. Gjenealitete të mëparshme

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)

EMËR	-----
MBIEMËR	-----
ATËSI	-----
AMËSI	-----
DATËLINDJE	-----
VENDLINDJE	-----

ILIR OBONI

(emër, mbiemër, nënshkrim)


II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT


Unë, i/e nënshkruari /a ILIR FAIK OBONI, kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

- a) Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.
- b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën vepër penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.
- c) Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- ç) Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.
- d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, pasjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.
- e) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

KUJDES: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTIJ SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARI!

ILIR OBONI 
(emër, mbiemër, nënshkrim)

ILIR OBONI


(emër, mbiemër, nënshkrim)

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:


Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
			Neni	Lloji
E LARTË	NR. 68, DATË 17.10.1991.	-	NENI 28/2 K.P.U	PËRJASHTOHET NGA DËNIMI LIHET PËR EDUKIM PRANË KOLEKTIVIT .

2. A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar	Gjykata	Vepra penale për të cilën jeni dënuar		Vendimi përfundimtar/Dënimi
		Neni	Lloji	

ILIR OBOINI


(emër, mbiemër, nënshkrim)

3. A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:


Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

4. A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË.	TIRANË	KUNDËRSHTIM TË PUNONJËSIT TË POLICISË TË RENDIT PUBLIK	12.06.2019-15.06.2019	PUSHIMIN E HETIMIT ME NR. 380 AKTI, DATË 17.02.2020, GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, "PASI FAKTI NUK PARASHIKOHET SI VEPËR PENALE ME LIGJ".

ILIR QBONI


(emër, mbiemër, nënshkrim)

5. A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? (Vendos X përbi përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

MASAT SHTRËNGUESE TË SIGURISË	PËRGJIGJE	
	Aktualisht në fuqi	E revokuar
Ndalimi i daljes jashtë shtetit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Detyrimi për tu paracjellur në polfide gjyqësore	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Garancia pasurore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Arrestimi në shtëpi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Arrestimi në burg	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shtrimi i perkohshëm në një spital psikiatrik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:


Gjykata	Qyteti, shteti	Vepra penale për të cilën akuzoheshit		Vendimi përfundimtar	Periudha, data
		Neni	Lloji		
E RRETHIT GJYËSOR TIRANË	TIRANË, SHQIPËRI	236/2	KUNDËRSHTIM PUNONJËSI TË RENDIT PUBLIK	PUSHIMIN E HETIMIT ME NR. 380 AKTI, DATË 17.02.2020, GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË "FAKTI NUK PARASHIKOHET SI VEPËR PENALE NGA LIGJI"	15.06.2019-17.02.2020

6. A është lëshuar ndonjëherë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale? (Vendos X përbi përgjigjes)

PO JO

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Autoriteti urdhërues	Arsyeja	Qyteti, Shteti	Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo)

ILIR OZONI


(emër, mbiemër, nënshkrim)

7. A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?

(Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj) (Vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja dëbimit	Periudha e dëbimit nga shteti i huaj	Të dhanat e aktit të dëbimit

8. A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO


JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja	Periudha	Adresa e vendqendrimit
ATALANTA, GREQI	EMIGRANT EKONOMIK	27.08.1996-12.11.1996	MEGAPLATANOS, ATALANTA, GREQI.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.


(emër, mbiemër, nënshkrim)

ILIR BOMI


(emër, mbiemër, nënshkrim)

Shënim: Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjitini një kopje të tyre këtij Formulari.

Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarin e të dhënave, shto aq pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.

ILIR QAZI


(emër, mbiemër, nënshkrim)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

NR. 380 AKTI

Dt. 07.01.2020 rregj.

Tirane me Dt. 17.02.2020

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, me trup gjykues te perbere nga:

GJYQTARI ARBEN MICKAJ

i asistuar nga sekretarja gjyqesore Merita Drishti(Kuci), sot ne Tirane, me 17.02.2020 mori ne shqyrtim ne seance paraprake, me dyer te mbyllura kerkesen penale qe i perket:

KERKUES : Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perfaqesuar nga prokurorja **Mirela Cano Zavalani (jo prezent ne shpallje).**

OBJEKTI : Dergimin per gjykim te procedimit penal me nr.4567, viti 2019, qe i perket:


I pandehur: **Sovran Pazaj**, i birii Sulodhe i Taze, dtl. 17.10.1970, lindur ne Vloredhe banues Tirane, Rr."Don Bosko", me arsim te mesem, gjendja civile i martuar, i padenuar, i martuar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare,hetuar me mase sigurimi "*Detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore*",i mbrojtur nga av.Bledar Meminaj, Anetar i Dhomes se Avokatise Tirane.

Akuzuar: Per kryerjen e vepres penale te "Kundershtim punonjesi te policise te rendit publik", te parashikuar nga neni 236/2te K.Penal.

Pushimin e pjesshem i procedimit penal nr.4567 te vitit 2019 persa i perket **shtetasit Ilir Oboni** pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.

BAZA LIGJORE: Neni 331 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi provat dhe ceshtjen ne teresi, si dhe degjoi pretendimet e paleve, ku prokurorja kerkoj pranimin e kerkeses dhe dergimin e ceshtjes per gjykim persa i perket te pandehurit **Sovran Pazaj** dhe pushimin per personin nen hetim **Ilir Oboni**, si dhe pasi degjoi



kundershtoje duke goditur me grusht edhe komandantin e sherbimeve Judovnik Mecka. Po ashtu pasagjeri i automjetit ka dale nga automjeti dhe ka filluar te ofendoje ne drejtim te punonjesve te policise pavaresisht se prej tyre po sqarohet qe duhet te qendronte brenda ne makine dhe nuk duhet te kundershtonte veprimet e tyre. Gjendur ne keto kushte jane thirrur perforcime duke proceduar me shoqerimin e ketyre shtetasve ne ambientet e Komisariatit Nr. 2 ne Tirane. Kallezuesi tregon se nga ana e punonjesve te policise nuk ka patur perdorim force.

Ne daten 12.06.2019 eshte proceduar me arrestimin ne flagrante te shtetasit Sovran Pazaj. Po ashtu eshte sekuestruar ne cilesine e proves materiale automjeti "Mercedez Benz" me targe TR7804M, leja e qarkullimit dhe certifikata e kontrollit teknik, te cilat rezultojne ne emer te shtetasit Erjon Xhani. Keto veprime jane vlefesuar nga ana e prokurorit ne daten 13.06.20 I 9. Kontrolli personal i shtetasit Sovran Pazaj nuk ka zbuluar sende me vlere per procedimin penal.

I pyetur ne kete date ne cilesine e personit nen hetim, ky shtetas ka deklaruar se shpjegimet do t'i jape ne gjykate.

Ne daten 12.06.2019 eshte proceduar me arrestimin ne flagrante te shtetasit Ilir Oboni, i cili eshte pasagjeri i automjetit te drejtuar nga shtetasi Sovran Pazaj ne kohen e zhvillimit te ngjarjes. Nga kontrolli personal nuk kane rezultuar sende me vlere, nderkohe qe i jane sekuestruar nje pale syze optike, veprim i vlefesuar me pas nga ana e prokurorit. I pyetur ne cilesine e personit nen hetim ky shtetas shpjegon se ditën e ngjarjes rreth ores 15:30, ka qene ne automjet me shtetasin Sovran Pazaj ne Lagjen "21 Dhjetori" kur i eshte bere me shenje ketij te fundit nga nje punonjes policie qe te hapte krahun. Biseden specifike te drejtuesit te mjetit me punonjesin e policise nuk e mban mend pasi nuk ka qene i vemendshern, por kujton se i eshte thene "*kam porosi per makinen tuaj*". Ky shtetas deklaroi se nuk eshte ushtuar dhune as nga ai dhe as nga shtetasi Sovran Pazaj ne dem te punonjesve te policise. Po ashtu deklaroi se nuk i ka kundershtuar per asnje moment punonjesit e policise por kane qene keta te fundit te cilet e kane prangosur ne publik madje punonjesi i pare qe i ndaloi e ka goditur me shpulle ne fytyre.

Ne daten 12.06.2019 eshte pyetur ne cilesine e personit qe ka dijeni shtetasi Fadil Balla, me detyre punonjes policie prane Komisariatit te Policise Rrugore Tirane. Ky shtetas shpjegon se:... eshte njoftuar nga komandanti i turnit per tu afruar prane kryqezimit te Lagjes "21 Dhjetori" pasi kerkohej perdorimi i aparatit mates te alkoolit tek drejtuesi i mjetit me targe TR7804M. Gjate komunikimit me drejtuesin e mjetit, pasagjeri i vendit te pare i ka kerkuar atij qe te mos pranoje kryerjen e testit te alkoolit. Drejtuesi i mjetit ka refuzuar testin e alkoolit dhe ka tentuar te levizi makinen por punonjesi Fadil Balla i ka dale perpara, per t'i lene te kuptonte se mjeti nuk duhej te levizte, nderkohe qe punonjesi tjetër Nertil Ago i ka hequr celesin nga kuadri. Pasagjeri i automjetit i identifikuar si shtetasi Ilir Oboni, ka dale perjashta duke kercenuar dhe ofenduar punonjesit e policise. Gjithashtu edhe drejtuesi i mjetit ka dale perjashta duke filluar te shtypte punonjesit e policise te cilet jane perpjekur ta fusnin perseri ne mjet. Ne keto caste drejtuesi i mjetit ka goditur me grusht ne fytyre komandantin e turnit shtetasin Judovnik Mecka. Me ndihmen e patrullave te policise te thirrura ne mbeshetje eshte bere shoqerimi i shtetasve te mesiperm.

Ne daten 12.06.2019 eshte pyetur ne cilesine e personit qe ka dijeni shtetasi Judovnik Mecka, me detyre Komandant Sherbimesh ne Komisariatit te Policise Rrugore ne Tirane. Ky shtetas shpjegon se:... ne kete date i eshte kerkuar nga punonjesi i policise Nertil Ago, i cili po kryente detyren prane kryqezimit te Lagjes "21 Dhjetori", nje sherbim i paisur me aparatit mates "Drager". Pasi eshte urdheruar afrimi i punonjesit qe kishte aparatit, ne mbeshetje te punonjesve ka shkuar dhe vete

Ne daten 05.11.2019 është ripyetur shtetasi Ilir Oboni i cili i qëndron deklarimeve të rreparshme të tij duke pretenduar se në asnjë moment as nuk ka ushtruar dhunë dhe as ka penguar punonjësit e policisë në kryerjen e detyrës,

Ne daten 05.11.2019 është pyetur perseri punonjësi i policisë Judovnik Mecka i cili sqaron se në lidhje me pretendimet e shtetasit Sovran Pazaj se është goditur me grusht në gjoks, nuk ka patur një veprim të tillë por në momentin që ky shtetas ka tentuar të levizë automjetin i janë hequr me forcë duart nga timoni dhe i janë vendosur në gjoks. Nderkohe në lidhje me veprimet e dhunës se ushtruar në dem të tij i qëndron deklarimeve të rreparshme.

Me vendimin e datës 28.06.2019 prokurori ka disponuar sekuestrimin e pamjeve filmike të kamerave trupore të punonjësve të policisë. Në datën 17.10.2019 është vendosur nga oficeri i policisë gjyqësore kryerja e ekspertimit të pamjeve filmike për të hedhur dritë mbi zhvillimin e

Me akt-ekspertimin teknik-vlerësues Nr.08.10 datë 24.10.2019 ka rezultuar se pamjet e kamerave trupore kanë vijueshmeri filmike. Në filmimet e kamerës trupore të punonjësit të policisë Nertil Ago vihet re afrimi i tij pranë automjetit me targë TR7804M, ku pasagjeri shikohet se është në gjendje gjumi.

Pas pyetjes se punonjësit të policisë, ai zgjohet dhe i përgjigjet mbi drejtuesin e mjetit. Me pas vihet re se drejtuesi i mjetit pasi është rikthyer ka filluar të levizë mjetin në drejtim të punonjësit të policisë me shpejtesë të ulët dhe drejtim për të hapur krahun, kur punonjësi i policisë e urdheron formalisht për këtë veprim. Në këtë moment fillon komunikimi i drejtuesit të mjetit me punonjësin e policisë, ku ky i fundit i kërkon dokumentet, ndërsa drejtuesi i shpjegon arsyen e ndalimit të automjetit. Vihet re se pas ardhjes së punonjësit tjetër të policisë me aparatën mates të alkoolit drejtuesi i mjetit refuzon testin, dhe pasi ka qenë jashtë mjetit (fq. 4 prg. 1 i akt-ekspertimit) kthehet brenda dhe fillon të levizë automjetin, duke thënë se po hap krahun. Këtu fillon acarimi i situatës ku punonjësit e policisë nderhyjnë për fikjen e automjetit, ndërsa drejtuesi i mjetit fillon të ofendojë punonjësit e policisë pasi është goditur nga një prej tyre. Situata agravohet me tej dhe pasagjeri i mjetit del përjashta për të sqaruar punonjësit e policisë, por neutralizohet prej këtyre duke u lidhur me prangë tek kangjellat ndarese të trotuarit anës rruges. Ky veprim shkakton ofendime në drejtim të punonjësve të policisë nga pasagjeri i mjetit. Pas këtij veprimi punonjësit e policisë kërkojnë që drejtuesit të mjetit t'i marrin telefonin që po e mbante në dorë me pretendimin se po filmohej ngjarja. Në përfundim të dy shtetasit që gjendeshin në automjetin futën në mjetet e policisë për shoqërim.

Në teresi, nga veprimet procedurale të mesipërme rezultoi se në datën 12.06.2019, punonjësi i policisë Nertil Ago, pas informacionit të marrë nga salla operative ka verifikuar automjetin e llojit "Mercedes Benz" me targë TR7804M, pasi dyshohej se drejtuesi i mjetit ishte në gjendje të dehur. Pasi i është afëruar mjetit që ka qenë parkuar përpara postës në Lagjen "21 Dhjetori" në Tiranë, ka konstatuar se pasagjeri Ilir Oboni gjendej në gjumë, e ka zgjuar atë dhe e ka pyetur mbi drejtuesin e mjetit. Me pas punonjësi i policisë është larguar disa metra me larg duke pritur që drejtuesi i mjetit të hipi në makinë. Me levizjen e automjetit nga drejtuesi Sovran Pazaj është urdheruar hapja e krahut nga punonjësi i policisë dhe pasi ai është prezantuar, ka kërkuar dokumentacionin e mjetit dhe patentën e drejtuesit. Për shkak të sjelljes së drejtuesit të automjetit, është kërkuar ardhja e një shërbimi të paisur me aparatën mates të alkoolit. Punonjësi i policisë i paraqitur me aparat ka qenë shtetasi Fadil Balla. Në këtë moment drejtuesi i automjetit, shtetasi Sovran Pazaj nuk ka pranuar të kryejë testin e

I pandehuri Sovran Pazaj gjate hetimeve paraprake dhe ne seancen paraprake, i asistuar edhe nga avokati i tij i kerkuan gjykates kthimin e akteve organit te prokurorise per hetime te metejshme.

Sipas avokatit mbrojtës te te pandehurit Sovran Pazaj, organi i akuzes ka bere shkelje proceduriale si me poshte vijon :

1. Kerkesa per dergimin e ceshtjes ne gjyq eshte nje akt absolutisht i pavlefshem rast ky i parashikuar nga neni 331/2 i K.Pr.Penale sipas te cilit nese kerkesa per dergimin e ceshtjes ne gjyq eshte bere ne kundershtrim me paragrafet 2,3,4 te nenit 327 konsiderohet e pavlefshme.

Neni 327/4 i K.Pr.Penale parashikon:

"I pandehuri njoftohet gjithashtu, se ka te drejte qe brenda dhjete diteve te paraqese memorie e dokumente, t'i kerkoje prokurorit kryerjen e hetimeve shtese, te beje deklarime apo te kerkoje qe te merret ne pyetje. Kur i pandehuri kerkon te pyetet, prokurori eshte i detyruar te procedoje me pyetjen e tij."

Ndersa neni 331/2 i K.Pr.Penale parashikon : "Kerkesa per dergimin e ceshtjes ne gjyq eshte e pavlefshme kur nuk respektohen percaktimet e paragrafeve 2, 3 dhe 4, te nenit 327, te ketij Kodi. "

Me konkretisht ne lidhje me rastin objekt gjykimi kerkesa per dergimin e ceshtjes ne gjyq mban daten 13.12.2019 ne pjesen hyrese ne faqen e pare(fq. 1 e fashikullit), ndersa ne te vertete nese i referohemi vete kerkeses per dergimin e ceshtjes ne gjyq ne (fq. 8 e fashikullit) ne te gjendet data 10.12.2019 e nenshkruar nga ana e Drejtuesit te Seksionit Kole Hysenaj. Pra data e vertete e kerkeses per dergimin e ceshtjes ne gjyq eshte data 10.12.2019.

Nderkohe qe vendimi per perfundimin e hetimeve eshte i dates 10.12.2019(fq. 180-187 e fashikullit) dhe ne respekt te nenit 327/4 te K.Pr.Penale te pandehurit i jepet nje afat 10 ditor per te kerkuar kryerjen e veprimeve hetimore shtese ose per te ngritur kerkesa te tjera procedurale. Kete kerkese taksative te ligjit e ka te qarte edhe prokurorja e ceshtjes e cila ia ka njoftuar kete te drejte te pandehurit me vendimin per perfundimin e hetimeve date 10.12.2019.

Por sic e kemi shpjeguar me lart ky afat prej 10 ditesh nuk i eshte dhene efektivisht te mbrojturit dhe te perfaqesuarit prej meje Sovran Pazaj pasi ceshtja eshte derguar ne gjyq me date 10.12.2019, kur ligji e detyron prokurorine qe ta dergoje pas afatit 10 ditor e parashikuar nga neni 327/4 i K.Pr.Penale. Pra ceshtja ne gjykate duhet te ishte sjelle pertej dates 20.12.2019 e permbledhje te asaj cfare kemi shprehur me lart na duhet te sqarojme se perfaqesuesja e akuzes ne te njejten date ka vendosur te marre si te pandehur Sovran Pazaj(fq. 167-173 e fashikullit), ne te njejten date ka kryer perfundimin e hetimeve pra me 10.12.2019 dhe pone te njejten date ka vendosur edhe dergimin e ceshtjes ne gjyq,madje kerkesa per dergimin e ceshtjes ne gjyq mund te jete edhe me e hershme pasi me date 10.12.2019 sic e kemi permendur me lart eshte firmosur nga shefi i seksionit. Sipas ketij konstatimi perfaqesuesja e akuzes me perpara ka perpiluar kerkesen per dergimin e ceshtjes ne gjyq se sa ka vendosur perfundimin e hetimeve duke vepruar ne kundershtrim flagrant me dispozitat e siperpemendura.

Madje nese do ti referohemi pv. per pyetjen si te pandehur te Sovran Pazaj date 13.12.2019(fq. 175-176 e fashikullit) rezulton se pyetja me cilesine e te pandehurit eshte bere pas perpilimit te kerkeses per dergimin e ceshtjes ne gjyq qe sic e kemi sqaruar me lart eshte e dates 10.12.2019.

2. Nga ana e organit te akuzes jane marre 3 vendime per te kryer akte ekspertimi mjekoligjor. Vendimi i pare eshte i dates 12.06.2019 (fq. 46 e fashikullit) nga OPGJ Jerelsi Lumi

Ne te njejten situatë procedurale është edhe rasti i caktimit të ekspertit Valter Haxhiraj si ekspert teknik vlerësues për të kryer ekspertimin e filmimit.

Pra nuk është respektuar dispozita e nenit 179/2 të K.Pr.Penale i cili detyron organin procedues për të njoftuar personin nën hetim për kryerjen e ekspertimit dhe caktimin e ekspertit. (fq. 63-72 e fashikullit)

Edhe në këtë rast në mbështetje të nenëve 128/a/1/c dhe 131/1 të K.Pr.Penale jemi përpara pavlefshmërisë absolute.

Detyrimin për njoftimin e ka pasur të qartë organi procedues pasi në nëse i referohemi faqeve 115 dhe 174 të fashikullit aty gjenden deklaratat e të drejtave në të cilat pasqyrohet saktësisht dhe qartësisht e drejta e personit nën hetim që të njoftohet dhe të kryejë pyetje ekspertit sikundër dhe të kërkojë ekspertim të ri.

3. Gjithashtu konstatohet lehtësisht se vepra penale për të cilën akuzohet i mbrojturi dhe i përfaqësuari prej meje Sovran Pazaj është kualifikuar sipas nenit 236/2 të K.Penal.

Nderkohe nëse do të referohemi të gjitha aktet që gjenden në fashikull rezulton qartësisht se jemi përpara kualifikimit të gabuar të veprimeve të kryera nga i mbrojturi dhe i përfaqësuari prej meje Sovran Pazaj.

Qartësisht nuk ekziston asnjë provë që të ngarkojë me përgjegjësi penale të mbrojturin dhe të përfaqësuarin prej meje Sovran Pazaj, për veprën penale të parashikuar nga neni 236/2 të K.Penal, pasi nuk është kryer asnjë veprim dhune nga ana e tij kundrejt punonjësve të policisë, kusht pa të cilin, vepra penale nuk mundet të kualifikohet si e tillë.

Një fakt i tillë është konstatuar edhe nga OPGJ i cili në relacionin e tij datë 22.11.2019 (faqe 188-194 e fashikullit) sugjeron ndryshimin e kualifikimit të veprës penale.

Në këtë relacion (fq. 194 e fashikullit) OPGJ arsyeton: "Mbeshtetur në rrethanat e faktit dhe të dhenat e mbledhura gjatë hetimit, për shtetasin Sovran Pazaj rezulton se nuk jemi përpara veprës penale sipas nenit 236 të K.Pr.Penale pasi nuk faktohet se ky shtetas të ketë kundërshtuar me dhunë punonjësit e policisë. Sipas kamerave të trupit ky shtetas nuk ka ushtruar në asnjë moment dhunë kundrejt punonjësve të policisë apo të ketë penguar për të kryer veprimet që kanë dashur të kryejnë. Gjithashtu nga ana objektive në momentin që ka dashur të levizë automjetin, është kryer si veprim për të hapur krahun me ire dhe nuk ka patur asnjë qëllim për të argur nga vendi i ngjarjes apo për të larguar punonjësit të policisë. Ky veprim ka patur për qëllim shmangien e një aksidenti duke qenë se automjeti ishte i ndaluar në mesin e rrugës.

Shtetasi Sovran Pazaj nuk i është bindur urdherit të punonjësit të policisë për të kryer testin e dragerit për të kërkuar të kryhet me gjak. Gjithashtu dhe pasi është shoqëruar ky shtetas është dërguar në spital për të marrë gjak ku dhe në këtë rast nuk ka pranuar, veprim i dokumentuar në raport shërbimi mbajtur në dt. 12.06.2019 nga punonjësi i policisë Dritan Sula.

Në këtë kusht në bazë të nenit 327/1 të K.Pr.Penale, sugjeroj që çështja për shtetasin Sovran Pazaj të ndryshohet kualifikimi i veprës penale nga neni 236 "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik" të K.Penal në nenin 242 të K.Penal "Mosbindje ndaj urdherit të punonjësit të policisë së rendit publik" dhe të komunikohet akuza.

Pra përfaqësuesja e akuzës në këtë çështje nuk e ka marrë parasysh relacionin e detajuar të paraqitur nga ana e OPGJ dhe në kundërshtim flagrant me atë çfarë ka rezultuar nga provat e grumbulluara gjatë hetimit nuk ka reflektuar në vendimmarrje gjendjen faktike të provave pra nuk ka ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale.



aktit te kryer ndaj shtetasit Ilir Oboni, nuk ka asnje dyshim se Sovran Pazaj e kishte marre cilesine e personit nen hetim ne momentin e kryerjes se aktit dhe per kete arsye keto akte duhet te deklarohen te pavlefshme duke u urdheruar organi i akuzes te kryej perseritjen e tyre ne baze te dispozitave te K.Pr.Penale qe flet per ekspertimin.

Gjithashtu prokurori duhet te kete parasysh se me daten 22.11.2019, oficeri i policise gjyqesore Z.Dritan Malaj ne referin te nenit 327/1 te K.Pr.Penale nga hetimet e kryera i ka sugjeruar prokurores qe ceshtja per shtetasin Sovran Pazaj ti ndryshohet kualifikimi i vepres nga neni 236 i K.Penal i "Kundershtim i punonjesit te policies se rendit publik" ne ate te Nenit 242 te K.Penal "Mosbindje ndaj urdherit te punonjesit te policise se rendit publik".

Gjykata e gjen te bazuar kerkesen e organit te akuzes ne lidhje me kerkesen per pushimin e pjesshem te ceshtjes penale nr.4567 te vitit 2019 persa i takon shtetasit Ilir Oboni pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.

PER KETO ARSYE

Gjykata, ne baze te nenit 332/ç te K.Pr.Penale

VENDOSI

- Kthimin Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane te akteve qe i perkasin procedimit penal te regjistruar me nr. 4567, date regjistrimi 13.06.2019, per vazhdimin e hetimeve per kete ceshtje sipas pjeses arsyetuese te gjykates.
- Veprimet hetimore te perfundojne brenda afatit 2 (dy) mujor, seanca e rradhes eshte me date 17.04.2020, ora 10.00.
- Pushimin e pjesshem te procedimit penal nr. 4567/2019, i regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 13.06.2019, persa i takon shtetasit Ilir Oboni pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.
- Kunder ketij vendimi mund te behet ankim nga personat ne hetim dhe viktimat, brenda 15 diteve ne Gjykatën e Apelit Tirane. Per palet jo prezent ne gjykim ky afat fillon nga e nesermja e komunikimit te vendimit
- U shpall sot ne Tirane, me 17.02.2020.

SEKRETARE

Merita Drishti(Kuci)


Vendimi mori forme te prere pasi
nuk u ankimua me dt 03.03.2020
Tirane me dt 23.02.2020

K / SEKRETAR

MIMOZA TAJA

GJYQTAR

ARBEN MICKAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

GJYKATA E LARTË

"KOLEGJI USHTARAK"

Nr.66 i Regj.Themeltar.

Nr.68 i Vendimit.



V E N D I M

"NE EMER TE POPULLIT"

Këshilli gjyqësor i kolegjit ushtarak të Gjykatës së Lartë, i formuar nën kryesinë e :

Fehmi Abdiu , Zëvendëskryetar i Gjykatës së Lartë
Rustem Gjata , Zëvendëskryetar i " "
Muharrem Kushi , Anëtar i " "

në seancën e hapët gjyqësore me datë 17.10.1991, mori në shqyrtim çështjen Nr.66 që i përket të pandehurit :

ILIR OBONI , i biri i Faikut, dhe i Esmasë, i dtl.1964, lindur e barmes në fshatin Tapi të rrethit të Beratit, me origjinë e gjendje shoqërore nëpunës, pa parti, me arsim të lartë, beqar, i padënuar më parë, i lirë.

I A K U Z U A R :

Se ka kryer krimin e shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal.

Me vendimin Nr.54, datë 30.8.1991, gjykata e rrethit të Beratit (kolegji ushtarak) e ka deklaruar të pandehurin fajtor dhe në bazë të nenit 106 të Kodit Penal e ka dënuar me 6 muaj riedukim nëpërmjet punës duke iu ndalur 1/4 e të ardhurave mujore.

Kundër këtij vendimi është ankuar i pandehuri, i cili ka parashtuar këto shkaqe për prishjen e tij :

Për veprën penale që kam kryer jam i penduar, por e kundërshtoj vendimin për llojin dhe masën e dënimit. Gjykata duhet të kishte marrë në konsideratë personalitetin tim. Unë, sig' del edhe nga karakteristika, kam qenë dhe jam mjaft i rregullt. Ngjarja është krejt e rastit. Prandaj kërkoj që ndaj meje të zbatohet neni 28 i Kodit Penal, kërkesë kjo që është paraqitur edhe nga komanda.

KESHILLI GJYQESOR I KOLEGJIT USHTARAK
TË GJYKATËS SË LARTË ;

pasi dëgjoi relacionin, e anëtarit Muharrem Kushi dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V E R E N :

I pandehuri Ilir Oboni është oficer aktiv pranë Repartit Ushtarak Nr.3117 Bulqizë.

Nga materialet e çështjes rezultoi se më 18 korrik të vitit në vazhdim i pandehuri Ilir ka filluar lejen e zakonshme dhe ka shkuar pranë prindërve të tij në fshatin Tapi të rrethit të Beratit.

Rrugën për në qytetin e Beratit i pandehuri e ka bërë me një shokun e tij, të quajturin Arben Kryemadhi, oficer po në repartin ushtarak ku është i pandehuri, me të cilin ka lënë për t'u takuar, para turizmit të Beratit në orën 18⁰⁰, të datës 23.7.1991, sepse Arbeni ka shkuar fillimisht në qytetin e Gërrikut, te prindërit e tij.

Në paraditen e datës së mësipërme, i pandehuri i veshur civil ka mbritur në qytetin e Beratit. Drekën e ka ngrënë në lokalin e Kalasë të këtij qyteti, ku ka pirë pije alkoolike dhe, në orën 18⁰⁰, sipas marrëveshjes, është takuar me dëshmitarin Arben.

I pandehuri Ilir ka qenë i shoqëruar me një vajzë e të tre së bashku janë futur në lokalin e turizmit, ku kanë pirë konjak. Mandej kanë dalë dhe pasi e kanë përcjellë te agjen-

cia vajzën me të cilën ka qenë i shoqëruar i pandehuri, të dy së bashku janë futur në një lokal privat dhe kanë vazhduar të pinë pi-
je alkolike deri në orët e vona, deri në atë shkallë sa janë dehur.

Në këtë gjendje ata kanë dalë nga lokali dhe janë nisur në drejtim të lagjes "Murat Çelepia", rrugës janë ndarë nga njëri-tjetri.

Të pandehurin, për shkak të dehjes e ka zënë gjumi në një stol në Lagjen "Barikada" dhe po kështu edhe dëshmitarin Arben, në afërsi të Kinoklubit "Tekstilisti".

Rreth orës 2.30' të datës 24.7.1991, i pandehuri është zgjuar dhe ka konstatuar se nuk kishte pistoletën, të cilën e ka patur me vete, në këllëf (pistoleta ka qenë e markës TT sovjetike me Nr.216).

Përsa sipër ai ka vënë në dijeni dy punonjësit e policisë, që janë ndodhur në afërsi të tij dhe mandej ka bërë denoncin, por pistoleta nuk është mundur të gjendet.

Veprimet e përmendura më lart, të kryera nga i pandehuri plotësojnë elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal.

Në rastin konkret, sikundër me të drejtë pranohet edhe nga gjykata e shkallës së parë, i pandehuri Ilir ka vepruar në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Ai ndonëse ka qenë me leje të zakonshme, përderisa pistoletën e ka mbajtur me vete duhet të zbatonte me rigorozitet të gjitha rregullat në lidhje me mbajtjen dhe përdorimin e saj.

Janë këto shkelje, që kanë shpënë në humbjen e pistoletës, gjë që nuk përjashtohet mundësia që t'i jetë vjedhur edhe nga elementë keqbërës.

Fajësia rezulton e provuar me pohimet e të pandehurit, thëniet e dëshmitarëve dhe provat e tjera të administruara gjatë gjykimit.

Por, gjykata ka gabuar në vlerësimin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe atë të vetë të pandehurit.

Siq përmendëm më lart, i pandehuri Ilir është karakterizuar nga sjellje dhe qëndrime mjaft të mira në punë e në shoqëri dhe ngjarja për të është krejt një rastësi.

Këshilli gjyqësor i këtij kolegji, duke patur para-
sysh edhe kërkesën e paraqitur nga komanda e repartit, me shkresën
e saj Nr.213, datë 2.9.1991, për t'ia lënë asaj për edukim, qmon
se edhe përjashtimi i tij nga dënimi duke ia lënë për edukim efek-
tivit të repartit do ta bëjë efektin e duhur edukativ.

PER KETIC ARSYE ,

Këshilli gjyqësor i kolegjit ushtarak të Gjykatës së
Lartë, në bazë të nenit 172/5 të K P Penale,

V E N D O S I :

Prishjen e vendimit Nr.54, datë 30.8.1991, të gjyka-
tës së rrethit Berati (kolegjit ushtarak) dhe duke e deklaruar
fajtor të pandehurin Ilir Oboni për veprën penale të shpërdorimit
të detyrës, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal, në bazë të
pikës 2 të nenit 28 të Kodit Penal e përjashton atë nga dënimi,
duke ia lënë për edukim efektivit të Repartit Ushtarak Nr.3117
Bulqizë.

Lënien në fuqi të vendimit të mësipërm për detyrimin
civil.

Tj,ranë, më 17.10.1991.

A N E T A R
/ M.Kushi /

M. Kushi

D. F.

Z V / K R Y E T A R
/ R. Gjata /

R. Gjata


Z V / K R Y E T A R
/ F. Abdiu /

F. Abdiu

VERTETOHET NJESIA ME ORIGINALIN

ADMINISTRATA GJYQESORE

Deris Nuredin



00345333



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Adresa: Rruga: "Zef Serembe"
17

Tel / Fax 00355 4 22 82 92
22/02/2021

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____

VËRTETIM
I GJENDJES GJYQËSORE

Në zbatim të nenit 484 të Kodit të Procedurës Penale, të Republikës së Shqipërisë, nga verifikimet që iu bënë shënimeve në regjistrin gjyqësor pranë kësaj Ministrie, rezulton se shtetasi (emri, mbiemri) ILIR OBONI

i biri (e bija) i FAIK dhe i ESMA
lindur më 01/05/1964 në TAPI E VOGEL, BERAT, ALB

1. ME VENDIM NR.54, DT.30.08.1991 GJYKATA USHTARAKE BERAT E KA DEKLARUAR FAJTOR PER VEPREN PENALE TE SHPERDORIMIT TE DETYRES, E NE BAZE TE NENIT 106 K.P. E KA DENUAR ME 6 MUAJ RIEDUKIM NEPERMJET PUNES, DUKE IU NDALUAR 1/4 E PAGES.
ME VENDIM NR.68, DT.17.10.1991 KOLEGJI USHTARAK I GJYKATES SE LARTE VENDOSI PRISHJEN E VENDIMIT E NE BAZE TE NENIT 28/2 K.P.U. E PERJASHTON ATE NGA DENIMI DUKE IA LENE PER EDUKIM EFEKTIVIT TE REPARTIT USHTARAK NR.3117 BULQIZE.

REHABILITUAR NE BAZE TE NENIT 69 K.PENAL.

Spektori i Gjendjes Gjyqësore

Arben Yusha
Sektori i Gjendjes
Gjyqësore
Arben YUSHA



200
LEKE
R-SHQIPERISE

DEKLARATË

e kandidatit të listës shumëmemërore
Partia Politike/ Koalicioni

e kandidatit të propozuar nga
zgjedhësit

(Përzgjidh me X)

LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

(plotëso emrin e partisë politike / koalicionit / kandidatit të propozuar nga zgjedhësit)

Zona Zgjedhore Qarku BERAT

në zgjedhjet për KUVEND, të datës 25.04.2021,

Bazuar në nenin 92/2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

Unë ILIR FAIK OBONI kandidat i listës shumëmemërore i partisë politike **LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM** deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër _____, pranë Bankës _____;

Unë _____ kandidat i propozuar nga zgjedhësit deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër _____, pranë Bankës _____;

Referuar nenit 92/2, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, autorizoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë.

Emër, mbiemër, firma

ILIR FAIK OBONI

[Signature]

DEKLARATË E KANDIDATIT

Model - 05

Propozuar nga zgjedhësit

Lista shumemërore Partia Politike

Lista shumemërore Koalicioni

(Përzgjidh me X)
(plotëso emrin e subjektit zgjedhor)

LËVIZJA

SOCIALISTE

PËR INTEGRIM

Zona Zgjedhore Qarku

BERAT

Deklaruesi:

ILIR FAIK OBONI

(emër, atësi, mbiemër)

Datëlindja

01 | 05 | 19 | 64

(datë - muaj - vit)

Adresa: "RRAPUSH PLAKU" ND. 4, H. 1, PERONDI, TAPL, KUCOVË

(Rruga, nr. godine, njësia administrative, qyteti)

Telefoni: 069 | 53 | 84 | 52 | 1

Gjinia F M

Bazuar në nenet 69 pika 2, 70 pika 2, 72 pika 2, gerrat "b", "c" dhe "ç", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se gëzoj të drejtën dhe pranoj të kandidoj si kandidat i mbështetur nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku _____, Bashkia _____ dhe se nuk jam pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në zgjedhje dhe as nuk do të mbështes haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në zgjedhje.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se gëzoj të drejtën dhe pranoj të kandidoj si kandidat i listës shumemërore të Partisë LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM në zonën zgjedhore Qarku BERAT.

Bazuar në përcaktimet e nenit 63, pika 4, të Kodit Zgjedhor, deklaroj se për shkak të këtij kandidimi kam deklaruar dorëheqjen nga funksioni i "INSPEKTORIT PRANË DREJTORISË SË VERIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT NË TERREN, RAJONI QENDROR, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE, TIRANË". paraqitur pranë DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, TIRANË.

(emri i institucionit)

Emër, mbiemër, firma

ILIR OBONI
[Signature]

Prot. DP. 3671 IST: 26. 2. 2021

Kërkesë për Dorëheqje

Tiranë më 26/02/2021

Drejtuar : Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Znj. Delina Ibrahimaj.

Drejtuar: Drejtoria e Burimeve Njerzore.

Pershendetje Znj, Ibrahimaj!


Ju lutem të pranoni këtë Kërkesë për dorëheqjen e pa revokushme timen nga pozicioni i inspektorit të Monitorimit në Teren, Drejtoria e Verifikimit dhe e Monitorimit në Terren , Rajoni Qëndror në Drejtorin e Përgjithshme të Tatimeve .

Kam vendosur të largohem për shkak të arsyeve personale dhe angazhimeve të tjera publike.

Dua t'iu falenderoj për vlersimin si dhe për besimin që patet ndaj meje.

Me Respekt

ILIR OBONI




Jetëshkrimi i kandidatit për deputet

Emër: ILIR
Atësia: FAIK
Mbiemër: OBONI
Datëlindja: 01/05/1964
Vendlindja: TAPI, KUÇOVË

Kandidat për **DEPUTET** në zgjedhjet **KUVEND**, të datës 25.04.2021 zonën zgjedhore **Qarku BERAT**.

Arsimi:

- Fituar titullin "Avokat" në dt. 02.12.2018 me nr. License 10523.
- Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës "Master Profesional në e Drejtë Penale. Diplomë me nr. 590, datë lëshimi 18.01.2018.
- Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti "Kristal", Diplomë e nivelit të Parë në Drejtësi. Diplome me nr.5307 dhe date lëshimi 28.10.2014.
- Akademia e Policisë "Arben Zylyftari", kurs 4-mujor për "Formimin Profesional të Policisë të Rolit të Mesëm", datë 12.06.2005.
- Shërbimi Informativ Kombëtar "Instituti". Diplomë me nr. 833 dhe datë lëshimi 29.02.2002.
- Shkolla e Latë e Bashkuar e Oficerëve, Diplomë nr.5795 dhe datë lëshimi 28.07.1986.




Eksperiencia në punë:

- Inspektorë në Drejtorinë e Verifikimit dhe Kordinimit në Terren, Rajoni Qëndrorë, Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve, Tiranë.
- Përgjegjës Sektori i Hetimit Tatimor në "Drejtorinë e Hetimit Tatimor", Rajoni Jugor Fier, Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve.
- Inspektor në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë.
- Përgjegjës i Sektorit të Hetimit në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë.
- Përgjegjës i Sektorit Operacional në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë.
- Drejtor i Emergjencave Civile në Këshillin e Qarkut Berat.
- Shef i Zyrës Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Drejtorinë e Policisë, Qarkut Berat, Ministria e Brendshme.
- Inspektor Antiterrori, në Drejtorinë e Shërbimit Informativ, Qarku Berat
- Shef i stërvitjes Brigadës Berat, Ministria e Mbrojtjes.
- Shef i zbulimit të Brigadës Bulqiz, Ministria e Mbrojtjes.


Kualifikimi:

- Çetifikatë për përfundimin e programit të trajnimit fillestar pranë Shkollës Komëtare të Avokatisë Tiranë, Tiranë më 10 Korrik 2018.
- Kursin e Formimit Profesional të oficerit të SH.K.B, Ministria e Brendshme Franceze, Qershor 2005.
- Kurs për Investigimin e Krimit, ICITAP, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Prill 2004.



Aktivite shoqërore dhe politike:

ILIR OBONI

ILIROBONI


Shënim: